RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË GALERINË KOMBËTARE TË ARTEVE



Tiranë, shtator 2026

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3**
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**3**
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**3**
	Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit	**5**
II.	**HYRJA**	**5**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**5**
2.	Identifikimi i çështjeve	**6**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	**6**
4.	Përgjegjësitë e audituesve	**6**
5.	Kriteret e vlerësimit	**6**
6.	Standardet e auditimit	**7**
7.	Metodat e auditimit	**7**
8.	Dokumentimi i auditimit	**7**
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**7**
1.	**Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	**7**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**	**7**
2.1.	Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit	**7-9**
2.2	Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave	**10**
IV.	**REKOMANDIME**	**11**

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", datë 27.11.2014, zhvilloi një auditim të Teknologjisë së Informacionit në Galerinë Kombëtare të Arteve (GKA) nga data 10.06.2026 deri më datë 15.07.2026.
Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.
Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

a.Përshkrim i shkurtër i Institucionit

Galeria Kombëtare e Arteve është institucion publik në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, me mision ruajtjen, pasurimin, studimin, promovimin dhe ekspozimin e trashëgimisë së arteve pamore në Republikën e Shqipërisë, si dhe nxitjen e zhvillimit të artit bashkëkohor dhe edukimit kulturor të publikut.
Galeria Kombëtare e Arteve (GKA) ka për mision grumbullimin, koleksionimin, konservimin, dokumentimin, studimin, restaurimin, ekspozimin dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në fushën e arteve pamore. Institucioni administron dhe pasuron fondin kombëtar të veprave të artit, duke garantuar ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e tyre sipas standardeve profesionale dhe muzeologjike. GKA promovon veprat më përfaqësuese të artit pamor shqiptar, si të traditës ashtu edhe të artit bashkëkohor, si dhe krijon hapësira për prezantimin e artit ndërkombëtar në Shqipëri. Përmes ekspozitave të përhershme dhe të përkohshme, projekteve kuratoriale, aktiviteteve edukative, botimeve dhe bashkëpunimeve me institucione kulturore brenda dhe jashtë vendit, Galeria kontribuon në edukimin artistik të publikut, nxit dialogun kulturor dhe mbështet zhvillimin e artit bashkëkohor. Gjithashtu, GKA luan një rol të rëndësishëm në promovimin e identitetit kulturor kombëtar, rritjen e aksesit të publikut në trashëgiminë artistike dhe integrimin e kulturës shqiptare në rrjetet dhe iniciativat ndërkombëtare të artit.

b. Rëndësia e Institucionit dhe e auditimit të tij

Galeria Kombëtare e Arteve luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen, administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kombëtare të arteve pamore, si dhe në zhvillimin e jetës artistike dhe kulturore në vend. Auditimi i Teknologjisë së Informacionit është i rëndësishëm për shkak të rritjes së varësisë së institucionit nga teknologjia dhe nevojës për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit, përfshirë të dhënat mbi koleksionet, dokumentacionin arkivor dhe shërbimet digjitale.
Përzgjedhja e këtij subjekti për auditim është bazuar në analizën e riskut të kryer gjatë hartimit të Planit Vjetor të Auditimit dhe Programit të Auditimit, ku është vlerësuar e nevojshme kryerja e auditimit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar efektivitetin e qeverisjes së TI-së dhe të kontrolleve të vendosura për mbrojtjen e informacionit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe objektivat

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i kuadrit të qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit në Galerinë Kombëtare të Arteve, me synim evidentimin e nivelit të organizimit, menaxhimit dhe kontrollit të burimeve të TI-së, si dhe përcaktimin nëse strukturat, politikat dhe procedurat e institucionit mbështesin përdorimin efektiv, të sigurt dhe të qëndrueshëm të Teknologjisë së informacionit. Auditimi është kryer për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, duke u fokusuar në drejtimin "Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit" dhe "Siguria dhe mbrojtja e të dhënave".

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Auditimi është realizuar në përputhje me standardet e auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, duke përdorur metodologjinë e auditimit të bazuar në risk. Kjo metodologji synon përqendrimin e procedurave audituese në proceset dhe kontrollet që paraqesin nivelin më të lartë të riskut, duke siguruar përdorimin efektiv dhe eficient të burimeve të auditimit.
Në përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit janë marrë në konsideratë rëndësia e proceseve të Teknologjisë së Informacionit, niveli i ekspozimit ndaj risqeve dhe ndikimi i tyre në funksionimin e institucionit.
Bazuar në punën në terren, grupi i auditimit vlerësoi se evidencat e mbledhura ishin të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për të mbështetur konkluzionet e auditimit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 623/1, datë 10.06.2026.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në raportin e auditimit janë formuluar 6 gjetje dhe 6 rekomandime për masa organizative.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Nga auditimi u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka në strukturën organizative një punonjës të dedikuar për Teknologjinë e Informacionit, përgjegjës për administrimin e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit, mirëmbajtjen e pajisjeve, ofrimin e mbështetjes teknike dhe menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, në mospërputhje me kërkesat e ISSAI 5310 për përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive në qeverisjen e Teknologjisë së Informacionit.
- Nga auditimi i qeverisjes së TI-së dhe administrimit të aseteve të TI-së u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk disponon politika, rregullore dhe procedura të dokumentuara për menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit, si dhe mungojnë procedurat për administrimin e aseteve IT, rinovimin e tyre dhe ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e materialeve dhe dokumentacionit dixhital të institucionit, në mospërputhje me kontrollin 5.1 dhe 5.9 të standardit ISO/IEC 27001:2022.
- Nga auditimi i procesit të administrimit dhe menaxhimit të aseteve të Teknologjisë së Informacionit u konstatua se rreth 30% e pajisjeve të inventarizuara (printera dhe kompjutera), kanë tejkaluar ciklin normal të përdorimit dhe janë të amortizuara, duke rritur rrezikun e dështimeve teknike, uljes së performancës së sistemeve, rritjes së kostove të mirëmbajtjes dhe cenimit të sigurisë së informacionit, në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar, si dhe kontrollin 5.9 të ISO/IEC 27001:2022..

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

- Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për garantimin e administrimit të Teknologjisë së Informacionit, nëpërmjet krijimit të një pozicioni të dedikuar ose një forme tjetër të përshtatshme organizative, me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e infrastrukturës dhe shërbimeve IT.
- Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave, rregulloreve dhe procedurave të Teknologjisë së Informacionit, duke përfshirë administrimin e aseteve IT, menaxhimin e materialeve dixhitale, mbrojtjen e të dhënave dhe proceset kryesore të TI-së, në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikat më të mira.

- Galeria Kombëtare e Arteve të hartojë dhe zbatojë një plan për rinovimin periodik të pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit, duke zëvendësuar pajisjet që kanë tejkaluar ciklin normal të përdorimit dhe duke standardizuar infrastrukturën teknologjike të institucionit.

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit:

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nga auditimi u konstatua se qeverisja e Teknologjisë së Informacionit në Galerinë Kombëtare të Arteve nuk është në përputhje të plotë me praktikat e mira të menaxhimit të TI-së dhe sigurisë së informacionit, duke evidentuar mangësi në qeverisjen e TI-së, të lidhura me mungesën e dokumentacionit, menaxhimin e riskut dhe mungesën e burimeve njerëzore për administrimin dhe funksionimin e teknologjisë së informacionit. Auditimi evidentoi mangësi në sigurinë fizike dhe logjike të infrastrukturës TI, përfshirë administrimin e aseteve. Këto mangësi ndikojnë negativisht në sigurinë, disponueshmërinë dhe efektivitetin e infrastrukturës dhe shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, duke rritur rrezikun për ndërprerje të shërbimeve, humbje të integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave, si dhe pamundësinë për të mbështetur në mënyrë efektive proceset dhe objektivat institucionale.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 623/1, datë 10.06.2026, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 10.06.2026 deri në 15.07.2026, në Galerinë Kombëtare të Arteve, (më poshtë GKA), ku periudha e audituar është 01.01.2025 deri në 31.12.2025, u krye auditimi me objekt "*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*", nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. A.K, anëtare
3. S.D, anëtare

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i auditimit është vlerësimi i përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të teknologjisë së informacionit nga Galeria Kombëtare e Arteve, me fokus tek ekzistenca dhe efektiviteti i kontrolleve kryesore për mbrojtjen e të dhënave. Auditimi ka pasur për qëllim të përcaktojë nëse praktikat e ndjekura janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të GKA dhe standardet e sigurisë së informacionit, si dhe nëse sigurohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit. Qëllimi i auditimit të kryer në Galerinë Kombëtare të Arteve është të ofrojë një vlerësim të pavarur mbi gjendjen aktuale të kontrolleve të teknologjisë së informacionit, në raport me menaxhimin, sigurinë, mirëmbajtjen dhe përdorimin e infrastrukturës ekzistuese. Auditimi synon të identifikojë dobësitë dhe proceset teknologjike, të vlerësojë rreziqet e mundshme. Për realizimin e këtij qëllimi, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna, dokumente, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310.

II.2 Identifikimi i çështjeve

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr. 623/1, datë 10.06.2026.
1. Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit
2. Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Galeria Kombëtare e Arteve ka si mision ruajtjen, administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kombëtare të arteve pamore, si dhe në zhvillimin e jetës artistike dhe kulturore në vend. Në këtë kuadër, strukturat drejtuese të institucionit mbajnë përgjegjësi thelbësore për orientimin strategjik, organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë veprimtarisë në këtë institucion. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave institucionale në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Galerinë Kombëtare të Arteve, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 deri në 31.12.2025, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 623/1, datë 10.06.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Galeria Kombëtare e Arteve. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë Raport Përfundimtar krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT, ISO/IEC 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sektorit Publik*", i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310.

II.7 Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Galerinë Kombëtare të Arteve, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Shqyrtimi i dokumentacioneve për infrastrukturën informatike që institucioni disponon;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit.

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Galeria Kombëtare e Arteve është institucion publik në varësi të Ministrisë përgjegjëse për kulturën, me mision ruajtjen, pasurimin, studimin, promovimin dhe ekspozimin e trashëgimisë së arteve pamore në Republikën e Shqipërisë, si dhe nxitjen e zhvillimit të artit bashkëkohor dhe edukimit kulturor të publikut. Galeria Kombëtare e Arteve (GKA) ka për mision grumbullimin, koleksionimin, konservimin, dokumentimin, studimin, restaurimin, ekspozimin dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në fushën e arteve pamore. Institucioni administron dhe pasuron fondin kombëtar të veprave të artit, duke garantuar ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e tyre sipas standardeve profesionale dhe muzeologjike. GKA promovon veprat më përfaqësuese të artit pamor shqiptar, si të traditës ashtu edhe të artit bashkëkohor, si dhe krijon hapësira për prezantimin e artit ndërkombëtar në Shqipëri. Përmes ekspozitave të përhershme dhe të përkohshme, projekteve kuratoriale, aktiviteteve edukative, botimeve dhe bashkëpunimeve me institucione kulturore brenda dhe jashtë vendit, Galeria kontribuon në edukimin artistik të publikut, nxit dialogun kulturor dhe mbështet zhvillimin e artit bashkëkohor. Gjithashtu, GKA luan një rol të rëndësishëm në promovimin e identitetit kulturor kombëtar, rritjen e aksesit të publikut në trashëgiminë artistike dhe integrimin e kulturës shqiptare në rrjetet dhe iniciativat ndërkombëtare të artit.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 623/1, datë 10.06.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:


- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Lista e punonjësve sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë;
- Përshkrimet e punës sipas akteve rregullative në fuqi;
- Regjistër risku si dhe planet e menaxhimit të tij për periudhën e audituar;
- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Etj.

Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit

<u>Vlerësimi i Burimeve Njerëzore</u>

Për kryerjen e funksioneve institucionale Galeria Kombëtare e Arteve ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 105, datë 25.07.2019 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Galerisë Kombëtare të Arteve*", me nr. 297/5 prot., datë 29.07.2019 e cila është e ndërtuar mbi bazën e dy Drejtorive dhe gjashtë Sektorëve ku dy nga sektorët kanë varësi direkte me Drejtorin e Përgjithshëm.

Diagrama nr.1: Organigrama e Galerisë Kombëtare të Arteve



Burimi: GKA, përpunuar nga grupi i auditimit

Numri i përgjithshëm në Galerinë Kombëtare të Arteve është gjithsej 28 punonjës.
- Në Galerinë Kombëtare të Arteve nuk ka një rregullore të brendshme për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë institucionale, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse.

Tabela nr.1: Struktura e Galerisë Kombëtare të Arteve sipas pozicioneve që ka secili punonjës

Nr.	Pozicioni	Nr. i punonjësve
Drejtori i Përgjithshëm		1
Sektori i Konservimit dhe Restaurimit		3
Sektori i Sigurisë dhe Mirëmbajtjes		7
Drejtoria e Edukimit dhe Organizimit të Ekspozitave		10
1	Sektori i Edukimit	3
2	Sektori i Organizimit të Ekspozitave	6
Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse		7
1	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	3
2	Sektori i Financës	3
Totali		28

Burimi: GKA, përpunuar nga grupi i auditimit

- Nga auditimi u konstatua se, Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka një punonjës të dedikuar për teknologjinë e informacionit, përgjegjës për mbështetjen teknike, administrimin e aseteve teknologjike dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me TI-në.

<u>Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK</u>
Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuara, monitorimit të rreziqeve të identifikuara më parë

dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre.
- Nga auditimi u konstatua se, Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka hartuar dhe nuk disponon regjistër risku në asnjë formë. Gjatë periudhës së audituar nuk rezulton të jenë identifikuar, dokumentuar dhe vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave institucionale.
Mungesa e regjistrit të riskut është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr. 14/2023, datë 16.02.2023, të cilat sanksionojnë detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut në njësitë publike.

Procedurat dhe rregulloret në TIK

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.
- Nga auditimi u konstatua se, Teknologjia e Informacionit në Galerinë Kombëtare të Arteve zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. GKA nuk disponon rregullat bazë udhëzues për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në kushtet e funksionimit të saj si dhe procedurave të proceseve të teknologjisë se informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, politika për rinovimin e aseteve për të ruajtur efikasitetin operacional etj.

Gjithashtu, u konstatua se GKA nuk disponon politika dhe procedura të dokumentuara për ruajtjen, arkivimin, administrimin dhe mbrojtjen e materialeve dixhitale që lidhen me veprat e artit, fotografitë, katalogët elektronikë dhe dokumentacionin e koleksioneve.

Transparenca e veprimtarisë së GKA-së

Faqja web e Galerisë Kombëtare të Arteve është under construction. Funksionimi i GKA-së duhet të jetë transparent në shërbim të publikut.
- Nga auditimi u konstatua se, Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka një faqe web funksionale ku të publikojë të dhënat që disponon, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, ku përcaktohet detyrimi i institucioneve publike për publikimin e informacionit të plotë, të saktë dhe të përditësuar për publikun.

Figura nr. 1: Faqja web e GKA-së



Burimi: Galeria Kombëtare e Arteve

2.2 Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 623/1, datë 10.06.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Verifikime mbi infrastrukturën;
- Intervista me punonjësit e institucionit;

Verifikimi i shkallës së sigurisë dhe aksesit në rrjet

Siguria e informacionit është e rëndësishme për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: "Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI". Verifikimi i shkallës së sigurisë me qëllim parandalimin e humbjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv. Auditimi mbi shkallën e sigurisë kompjuterike është bazuar në manualin e auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001.

- Nga auditimi i listës së inventarit të pajisjeve IT rezultoi se Galeria Kombëtare e Arteve disponon një infrastrukturë të përbërë nga kompjuterë desktop, laptopë, monitorë, printerë, skanerë dhe pajisje UPS. Megjithatë, u konstatua se një pjesë e pajisjeve kompjuterike janë modele të prodhuara shumë vite më parë, si HP 500B (2011), Dell Optiplex 740, Dell Optiplex 980, HP Workstation Z400, Apple iMac 2014 dhe MacBook Air 2014, të cilat kanë tejkaluar ciklin normal të përdorimit.

Përdorimi i pajisjeve të amortizuara rrit rrezikun e dështimeve teknike, ul performancën e sistemeve të informacionit, rrit kostot e mirëmbajtjes dhe mund të krijojë problematika në aspektin e sigurisë së informacionit, për shkak të kufizimeve në mbështetjen me përditësime të sistemeve operative dhe drejtuesve (drivers).

Si rrjedhojë, Galeria Kombëtare e Arteve nuk disponon një infrastrukturë pajisjesh IT plotësisht të rinovuar dhe të standardizuar, duke krijuar rrezik për vazhdimësinë e veprimtarisë dhe efikasitetin e shërbimeve që mbështeten në teknologjinë e informacionit.

- Nga auditimi u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk disponon një sistem të licencuar dhe të centralizuar antivirusi (Endpoint Protection) për stacionet e saj të punës (23 kompjuterë desktop dhe laptopë të shpërndarë në Sektorin e Restaurimit dhe zyrat pranë Albafilm), duke lejuar funksionimin e pajisjeve pa mbrojtje logjike ndaj kërcënimeve kibernetike. Kjo mangësi rrit ndjeshëm riskun për përhapjen e viruseve, malware, sulmeve ransomware dhe përdorimin e paautorizuar të pajisjeve të jashtme (USB/External HDD) për transferimin e materialeve zyrtare apo të dhënave të restaurimit. Mungesa e këtyre masave mbrojtëse cenon drejtpërdrejt disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave shtetërore dhe trashëgimisë kulturore digjitale, në mospërputhje me Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022, si dhe kuadrin ligjor vendas për sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa është trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e auditimit.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka në strukturën organizative një punonjës të dedikuar për Teknologjinë e Informacionit, përgjegjës për administrimin e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit, mirëmbajtjen e pajisjeve, ofrimin e mbështetjes teknike dhe menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, në mospërputhje me kërkesat e ISSAI 5310 për përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive në qeverisjen e Teknologjisë së Informacionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për garantimin e administrimit të Teknologjisë së Informacionit, nëpërmjet krijimit të një pozicioni të dedikuar ose një forme tjetër të përshtatshme organizative, me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të menaxhimit të riskut u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka hartuar dhe nuk administron regjistër risku, si dhe nuk rezulton të ketë identifikuar, dokumentuar dhe vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave institucionale, në kundërshtim me nenet 10 dhe 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për hartimin, miratimin dhe përditësimin periodik të regjistrit të riskut, duke identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar risqet që lidhen me Teknologjinë e Informacionit, përfshirë infrastrukturën, të dhënat dhe shërbimet e TI-së, me qëllim sigurimin e menaxhimit efektiv të risqeve dhe vazhdimësisë së veprimtarisë institucionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i qeverisjes së TI-së dhe administrimit të aseteve të TI-së u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk disponon politika, rregullore dhe procedura të dokumentuara për menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit, si dhe mungojnë procedurat për administrimin e aseteve TI, rinovimin e tyre dhe ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e materialeve dhe dokumentacionit dixhital të institucionit, në mospërputhje me kontrollin 5.1 dhe 5.9 të standardit ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave, rregulloreve dhe procedurave të Teknologjisë së Informacionit, duke përfshirë administrimin e aseteve TI, menaxhimin e materialeve dixhitale, mbrojtjen e të dhënave dhe proceset kryesore të TI-së, në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikat më të mira.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të informimit dhe transparencës nëpërmjet mjeteve të Teknologjisë së Informacionit u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk ka një faqe zyrtare funksionale të internetit për publikimin e informacionit institucional, duke mos garantuar transparencën dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për informimin e publikut, në mospërputhje me ligjin nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për vënien në funksionim të plotë të faqes zyrtare të internetit dhe publikimin e informacionit të detyrueshëm, duke garantuar transparencën institucionale.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të administrimit dhe menaxhimit të aseteve të Teknologjisë së Informacionit u konstatua se rreth 30% e pajisjeve të inventarizuara (printera dhe kompjutera), kanë tejkaluar ciklin normal të përdorimit dhe janë të amortizuara, duke rritur rrezikun e dështimeve teknike, uljes së performancës së sistemeve, rritjes së kostove të mirëmbajtjes dhe cenimit të sigurisë së informacionit, në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar, si dhe kontrollin 5.9 të ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqen 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një plani për rinovimin periodik të pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit, duke parashikuar zëvendësimin e pajisjve që kanë tejkaluar ciklin normal të përdorimit, si dhe standardizimin dhe përditësimin e infrastrukturës teknologjike të institucionit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së infrastrukturës TI u konstatua se Galeria Kombëtare e Arteve nuk disponon një sistem të licencuar dhe të centralizuar të mbrojtjes antivirus (Endpoint Protection) për pajisjet fundore, duke ekspozuar infrastrukturën IT ndaj kërcënimeve kibernetike dhe duke rritur rrezikun për cenimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit, në kundërshtim me kontrollin 8.7 të standardit ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqen 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Galeria Kombëtare e Arteve të marrë masa për implementimin e një zgjidhjeje të licencuar dhe të centralizuar të mbrojtjes antivirus (Endpoint Protection) për të gjitha pajisjet fundore, si dhe për administrimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të saj, me qëllim forcimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT